

Vendim nr. 288 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (H) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: HAKI AHMETA, përfaqësuar nga avokat Mitër Muça, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 550, datë 09.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 552 (86-2017-546), datë 15.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2024-276, datë 30.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, me vendimin e datës 24.02.2009 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Tiranë, në bazë të ligjit nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Policisë së Shtetit” (*Ligji i vjetër për Pensionet Suplementare*), ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 33 600 lekë në muaj.

2. Në datën 27.06.2009 hyri në fuqi ligji i ri nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji i ri për Pensionet Suplementare*). Neni 29 i këtij ligji parashikonte rillogaritjen e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, duke filluar nga data 01.07.2009. Mbi bazën e Ligjit të ri për Pensionet Suplementare, DRSSH-ja, Tiranë ka rishqyrtuar rastin e kërkuesit dhe në datën 22.09.2014 i ka komunikuar atij se nga rillogaritja, masa e pensionit të parakohshëm ishte në masën 15 535 lekë dhe se ai ishte debitor për periudhën 01.07.2009 - 22.09.2014.

3. Duke mos qenë dakord me rillogaritjen e pensionit të parakohshëm, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Tiranë t’i paguajë pensionin e parakohshëm deri në daljen në pension pleqërie, në masën që përfitonte përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Pensionet Suplementare, si dhe kamatëvonesat respektive. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 550, datë 09.02.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se situata juridike e kërkuesit për përfitimin e pensionit të parakohshëm të përcaktuar me Ligjin e vjetër për Pensionet Suplementare kishte ndryshuar me ligjin e ri, për rrjedhojë, pas datës 30.06.2009 kërkuesi përfitonte pension të parakohshëm në bazë të këtij të fundit dhe sipas kushteve të përcaktuara në të.

4. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 552 (86-2017-546), datë 15.02.2017, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-276, datë 30.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji.

5. Në datën 27.07.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 6.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi kërkueti kishte fituar të drejtën për pension të parakohshëm në masën e përcaktuar nga Ligji i vjetër për Pensionet Suplementare, masë e cila është rillogaritur dhe ulur me hyrjen në fuqi të ligjit të ri. Gjykatat e zakonshme, duke mos pranuar padinë e kërkuetit, kanë cenuar të drejtën e fituar, ndërsa atij i është ulur niveli i jetesës me 19 409 lekë më pak në muaj.
- 6.2. *Fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës*, pasi gjykatat e zakonshme në kundërshtim me vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës, kanë ligjëruar rillogaritjen dhe zvogëlimin e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuetit, edhe pse rasti i tij nuk përfshihej në rastet përjashtimore ku vepronte fuqia prapavepruese e Ligjit të ri për Pensionet Suplementare.
- 6.3. *E drejta për një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe të caktuar me ligj*, pasi gjykatat e zakonshme kanë keqzbatuar dhe keqinterpretuar fuqinë prapavepruese të Ligjit të ri për Pensionet Suplementare, si dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ky i fundit ka konkluduar se kur nga ndryshimi i legjislacionit, përfituesve u vijnë pasoja të pafavorshme, ligji nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues.
- 6.4. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë është mjaftuar me vlerësimin se rekursi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji, pa u shprehur për të gjitha çështjet e ngritura në rekurs, konkretisht ato referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe vendimit të Gjykatës. Nëse Gjykata e Lartë do ta arsyetonte vendimin, atëherë do të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pranimin e rekursit të kërkuetit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për pasojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët nëpërmjet njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 30.01.2024 të Gjykatës së Lartë. Vendimi i është njoftuar avokatit të kërkuesit (që e ka përfaqësuar atë në Gjykatën e Lartë dhe vazhdon ta përfaqësojë edhe në gjykimin kushtetues) me anë të postës elektronike në datën 11.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 27.07.2024, pra pas 4 muajve e 16 ditëve nga njoftimi i vendimit, që konsiderohet si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave. Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë të dhënë ose argument që lidhet me mosrespektimin prej tij të afatit ligjor. Në këto kushte, Kolegji vlerëson

se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.